



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_273_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_387_04_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_387_04_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Eqrem Cenollari (shifra e konsumatorit DPZ – 9020930) nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 11.11.2009, ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 10.11.2009 lidhur me kontestimin e borxhit të energjisë elektrike.

- Me datë 12.08.2005 konsumatori Arton Xhaferi (shfrytëzues i lokalit) ka nënshkruar kontratë për shërbimet e energjisë elektrike me KEK-un, shifra e konsumatorit në KEK është DPZ – 9020930.

Provë: Kontrata për shërbimet e energjisë elektrike.

- Me datë 12.08.2005, konsumatori Arton Xhaferi (shfrytëzues i lokalit) ka nënshkruar kontratë për rregullimin e borxhit me KEK-un në vlerë prej 1,566.15 €, e cila shumë duhet të paguhet me 26 këste mujore, ku vlera e këstit mujor është 51.00 €, shifra e konsumatorit DPZ – 9020930. Me këtë kontratë Arton Xhaferi ka marrë obligim për kryerjen e obligimeve financiare ndaj KEK-ut.

Provë: Kontrata për rregullimin e borxhit e datës 12.08.2005

- Me datë 02.11.2009, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar borxhin e krijuar të energjisë elektrike nga Arton Xhaferi, i cili ka qenë shfrytëzues i lokalit afarist.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 10.11.2009, Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 10.11.2009
- Me datë 11.11.2009, konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 387_04_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar